


Pranuar me: 12. 01. 2023			
Ni. org.	Numër	Shitja	Vlerë
01	70	1	

	
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA INSTITUTE OF HISTORY - INSTITUT ZA ISTORIJU	
Njësia Org.	Nr. l. prot.
Org. Unit.	Prot. N.
Org. Jed. 14	Br. Prot. 04/169/23
Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë	
Nr. i Faldit	Date:
No. Pages	12.01.2023
Br. i...	
PRISHTINE - A	



Fakulteti Filozofik
Departamenti i Historisë

Prishtinë, më 12 / 01 / 2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

INSTITUTIT TË HISTORISË "ALI HADRI", PRISHTINË

DHE

FAKULTETIT FILOZOFIK-DEPARTAMENTI I HISTORISË

Neni 1

Palët

Palët në këtë Marrëveshje janë: Instituti i Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë, përfaqësuar nga u.d. drejtori dhe Departamenti i Historisë përfaqësuar nga Shefi i Departamentit.

Neni 2

Objekti dhe Qëllimi

- Objekti i kësaj marrëveshje mes palëve nënshkrues është vendosja e bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën kërkimore-shkencore dhe akademike, duke përcaktuar fushëveprimin dhe objektivat e bashkëpunimit.
- Palët bien dakord që të bashkëpunojnë më qëllim për realizimin e interesave të dyanshme në fushën kërkimore – shkencore dhe akademike.
- Nga kjo marrëveshje në kuadër të bashkëpunimit do të përfitojnë studiuesit e të dyja palëve, nënshkruese.

Neni 3

Veprimtaria e përbashkët e palëve

Palët nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të përcaktuar në Nenin 1 të kësaj marrëveshje marrin përsipër të kryejnë bashkërisht:

1. Që të hartojnë një kalendar të aktiviteteve të përbashkëta shkencore.
2. Që të bashkëpunojnë për organizimin dhe jetësimin e aktiviteteve shkencore dhe akademike: Konferencave, Simpoziumeve, Tryezave shkencore, ligjëratave, hulumtimeve dhe projekteve shkencore që organizohen nga këto institucione.
3. Që të botojnë studime monografike dhe vëllime dokumentare nga fusha e historisë dhe të angazhohen në promovimin e tyre.
4. Që të kenë pjesëmarrje të ndërsjellë në redaksitë e revistave shkencore të cilat botohen në kuadër të këtyre institucioneve.
5. Që të organizojnë debate lidhur me aspekte të ndryshme të historisë.
6. Që të organizojnë cikël ligjëratash ku do të angazhohen studiuesit e Institutit të Historisë në ato tema ku janë të specializuar.
7. Palët pajtohen që të shkëmbejnë të gjitha botimet e realizuara duke siguruar nga një kopje për secilin punonjës shkencor.
8. Palët pajtohen për angazhimin e stafit të Institutit të Historisë në mësimdhënie për lëndë të caktuara.
9. Palët pajtohen që të mbështesin administrativisht kërkuesit shkencorë për lehtësimin e procedurave për shfrytëzimin e literaturës në bibliotekat përkatëse të tyre.
10. Përfshirja e stafit si anëtarë komisioni në cilësinë e recensentit në botime të ndërsjella në varësi të fushave specifike.
11. Angazhimi i stafit si anëtarë të komisioneve të përbashkëta me rastin e mbrojtjes së diplomave në nivelet: Bsc, Ma dhe Dr.
12. Në bazë të nevojave të tyre, në raste të caktuara, krijojnë komisione profesionale dhe grupe pune të përbashkëta për zhvillimin e projekteve, strategjive dhe hulumtimeve.
13. Palët pajtohen që të bashkëpunojnë edhe në çështje të tjera të cilat ndërlidhen me punët kërkimore-shkencore dhe akademike.

Neni 4

Personat e kontaktit

1. Më nënshkrimin e kësaj Marrëveshje personat e kontaktit janë personat e caktuar në Nenin 1 të kësaj marrëveshje, të cilët do të jenë përgjegjës për bashkërendimin e aktiviteteve kërkimore- shkencore dhe akademike dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 5

Mosmarrëveshjet

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindin mes palëve në lidhje me këtë Marrëveshje zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe përmes negociatave ndërmjet tyre.

Neni 6

Kohëzgjatja dhe anulimi

1. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshjeje është 4 (katër) vjet.
3. Me vullnetin e palëve Marrëveshja mund të ripërtërihet.
4. Kjo Marrëveshje mund të anulohet me vullnetin e palëve.
5. Pala që dëshiron anulimin është e obliguar që të njoftojë palën tjetër, të paktën 1 (një) muaj përpara.


Neni 7

Dispozita të përgjithshme


1. Palët obligohen që ta respektojnë këtë marrëveshje për gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në nenin 6 të saj.
2. Palët do të përmbushin detyrimet e parapara në këtë marrëveshje pa pretendime financiare ndaj palës tjetër.
3. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e hartuar në 4 (katër) kopje, nga 2 (dy) për secilën palë.

PALËT NËNSHKRUESE

Për
Institutin e Historisë "Ali Hadri", Prishtinë
u.d. Drejtori
Prof. Dr. Teuta Shala-Peli



Për
Fakultetin Filozofik
Dekani
Prof. Asoc. Dr. Dashamir Bërxulli



Për
Departamentin e Historisë
Shefi i Departamentit
Dr.sc. Mentor Hasani